



DEPARTAMENTI I AKTEVE RREGULLATRE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA
Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik

Tiranë, 8 qershor 2026

VLERËSIM

Lënda: Vlerësim i draft raportit të ndikimit rregulator (RIA) për projektligjin “Për Informacionin Elektronik të Transportit të Mallrave”.

Vlerësimi i përgjithshëm: 84/100¹ Përgjithësisht pozitiv

A) Informacione të përgjithshme mbi procesin

Emërtimi i propozimit të politikës Projektligji “Për Informacionin Elektronik të Transportit të Mallrave”.

Ministria udhëheqëse	MEI
Numri/data e RIAs	2026 – MEI – Nr.8
Statusi	Finalizuar
Data e marrjes për shqyrtim	17 mars 2026
Data e komenteve të fundit	5 qershor 2026
Numri i komenteve të kryera/të reflektuara	39/30
Numri i ripunimeve	5

B) Konteksti i politikës

Qëllimi i kësaj nisme është krijimi i kuadrit ligjor për përdorimin dhe pranimin e informacionit elektronik të transportit të mallrave (eFTI) në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Rregulloren (BE) 2020/1056 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 15 korrik 2020, “Për informacionin elektronik të transportit të mallrave”.

C) Vlerësimi i përgjithshëm

Drejtoria vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për të siguruar se ndërhyrja e qeverisë është e orientuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate sa më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

Për arsyet e lartpërmendura, Drejtoria vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, është

¹ Pragu minimal i pikëve që një raport RIA të konsiderohet i konfirmuar është 70.

përgjithësisht në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit. Institucioni ka evidentuar problemet duke shpjeguar shkaqet dhe efektet e tyre; grupet e prekura; arsyet e ndërhyrjes dhe lidhjen e nismës me objektivat e nivelit të lartë. Njëkohësisht, është kryer një analizë mjaftueshmërisht cilësore dhe sasiore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare dhe sociale, të opsionit të preferuar. Gjithashtu, çështjet që lidhen me zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e ecurisë së arritjes së objektivave të vendosura janë trajtuar në një mënyrë përgjithësisht të detajuar.

D) Rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të RIAs

Në vijim të gjetjeve të lartpërmendura, konsiderojmë se në mënyrë që RIA të jetë plotësisht në përputhje me kriteret e përcaktuara nga metodologjia, nga ana e strukturës hartuese duhet:

1. Të përmirësohet më tej analiza cilësore e ndikimeve, si dhe analiza e detajuar sasiore për secilin nga grupet e prekura, duke përshkruar dhe monetizuar më tej kostot dhe përfitimet që rrjedhin nga ndërhyrja ligjore.
2. Të plotësohen sipas kërkesave të formatit dhe Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit shtojcat 2/a dhe 2/b të RIAs.